



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

NJOFTIM
“PËR ÇELJEN E GARËS PËR DHËNIEN E 1 (NJË) LICENCE TRANSMETIMI AUDIO ANALOGE”

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), në mbështetje të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, rregullores “Për procedurat dhe kriteret për dhënien e licencës së transmetimit audio analoge”, miratuar me vendim nr. 7, datë 21.02.2023 të AMA-s, si dhe vendimit nr. 6, datë 24.01.2024 të AMA-s, “Për çeljen e garës për dhënien e licencave të transmetimit audio analoge”, do të organizojë procedurën e përzgjedhjes së kandidaturave për dhënien e 1 (një) licence transmetimi audio analoge, të përbërë nga:

- licenca e shërbimit të programi audio;
- licencë për ndërtimin e operimin e rrjetit analog.

Për zonat e mëposhtme:

<i>Pika e transmetimit</i>	<i>Frekuenca MHz</i>	<i>Koordinatat X Y Z</i>	<i>Fuqia Nominale (W)</i>	<i>Amplifikimi (dBi)</i>	<i>EIRP (W)</i>	<i>Azimuth (deg)</i>	<i>Lartësia e Antentës (m)</i>	<i>Drejtimi i Antentësi</i>
Poliçan	94.0	20.061E 40.364N 4DMS	100	7.2	524.8	NA	16	ND
Skrapar	89.0	20.135E 40.312N 4DMS	100	7.2	524.8	NA	16	ND

Subjektet e interesuara për t’u pajisur me licencë transmetimi audio analoge, janë të lutur që të depozitojnë aplikimet në Autoritetin e Mediave Audiovizive, Rruga “Papa Gjon Pali II”, Nr. 15, Kutia Postare 1010, Tiranë, ***brenda datës 05.03.2024, ora 10:00.***

Dokumentacioni i plotë i konkurrimit të kandidaturave, që përfshin:

- Rregulloren “Për procedurat dhe kriteret për dhënien e licencës së transmetimit audio analoge”, e ndryshuar;
- Kërkesat që duhet të plotësojë aplikimi;
- Kriteret teknike për ofrimin e shërbimit audio përfshirë frekuencën/frekuencat dhe pikën/pikat e transmetimit për zonën e shërbimit;

- Pagesat për licencën, tarifat përkatëse dhe mënyrën e pagesës së tyre;

mund të tërhiqet në zyrën e Arkivë-Protokollit, në AMA, pas kryerjes së pagesës në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve, nga çdo subjekt që synon të marrë pjesë në konkurrim.

Aplikimet do të hapen ***në datë 05.03.2024, ora 10:00, në mjediset e AMA-s***, ku subjektet aplikues apo përfaqësuesit e autorizuar prej tyre, kanë të drejtë të jenë të pranishëm në momentin e hapjes së dosjeve të aplikimit.